



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**  
**-Këshilli Drejtues-**

---

**V E N D I M**

**Nr.1487, datë 10.01.2011**

**Për**

**“Mbylljen e procedimit administrativ të filluar me Vendimin nr. 1450, datë 12.11.2010, të KD të AKEP për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Eagle Mobile sh.a dhe Vodafone Albania sh.a”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Z. Ibsen	Elezi	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 10.01.2011, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brëndshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

Mbylljen e procedimit administrativ të filluar me Vendimin nr. 1450, datë 12.11.2010, të KD të AKEP, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Eagle Mobile sh.a dhe Vodafone Albania sh.a,

**BAZA LIGJORE:**

1. Neni 120, i ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr. 9918*);

2. Nenet 66-104 e vijues të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (K.Pr.A);
3. Rregullore nr.18, datë 11.06.2010 “Për procedurat e zgjidhjes se mosmarrëveshjeve”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 1296, datë 11.06.2010;
4. Rregullore nr.19, datë 14.06.2010, “Për Aksesin dhe Interkoneksionin”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 1300, datë 14.06.2010, e ndryshuar;
5. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendshme të AKEP (**Rregullorja e Brendshme**), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918.
6. Vendimin nr. 1450, datë 12.11.2010, të KD të AKEP “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Eagle Mobile sh.a dhe Vodafone Albania sh.a”;

### **K Ë S H I L L I D R E J T U E S :**

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Vendimi nr. 1450, datë 12.11.2010, të KD të AKEP, “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Eagle Mobile sh.a dhe Vodafone Albania sh.a”;
2. Pretendimet e paleve te depozituara ne vijim te vendimit nr. 1450, datë 12.11.2010:
  - a. Vodafone Albania me shkresen Ref CEO/0126/Exh, date 3.12.2010;
  - b. EM me shkresen Nr.5358.Prot, date 3.12.2010.
3. Shkresa e Vodafone Albania sh.a nr. LGD/0393/AC, datë 14.12.2010 ( AKEP: 3500 prot, datë 14.12.2010), me ane te së cilës dërgohet kopje e MI të nënshkruar midis palëve me datë 10.12.2010;
4. Shkresa e Eagle Mobile sh.a, nr. 5550 prot, datë 15.12.2010 (AKEP: nr. 3500/1 prot, datë 16.12.2010), “Tërheqje nga procedimi administrativ për zgjidhjen e mosmarreveshjes së interkoneksionit midis Eagle Mobile sh.a dhe Vodafone Albania sh.a”;
5. Relacion shpjegues mbi projektvendimin (**Relacioni**);

## V Ë R E N se:

1. AKEP, me Vendimin nr. 1450, datë 12.11.2010, të KD, ka filluar procedimin administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Eagle Mobile sh.a dhe Vodafone Albania sh.a. Sipas pikës nr. 4, të këtij vendimi palët duhet të depozitonin pretendimet e tyre me shkrim brenda 15 ditëve nga marrja e vendimit.
2. Vodafone dhe EM kanë depozituar pretendimet për mosmarrveshjen për lidhjen e MI, ku vihet re se objekt mos-marrveshje (per lidhjen e MI se re) ka qënë tarifa e terminimit në rrjetin EM në periudhën 1.04.2010-23.07.2010, për shkak të interpretimeve të ndryshme të palëve për këtë tarifë në vijim të vendimeve të AKEP dhe ankimit administrativ të EM në periudhën 31.03.2010-23.07.2010.
3. Vodafone Albania sh.a me shkresën nr. LGD/0393/AC, datë 14.12.2010 ( AKEP: 3500 prot, datë 14.12.2010), depoziton në AKEP kopje e MI të nënshkruar midis palëve me datë 10.12.2010, duke kërkuar njëkohësisht përgjigje nga AKEP, për çështjen e zbatimit të tarifave midis Eagle Mobile dhe Vodafone Albania për periudhën Prill – Korrik 2010.
4. Pala investuese administrative në këtë procedim Eagle Mobile sh.a, me shkresën nr. 5550 prot., datë 15.12.2010, (nr. 3500/1 prot. i AKEP, datë 16.12.2010), ka bërë kërkesë për tërheqje nga procedimi administrativ për zgjidhjen e mosmarreveshjes së interkoneksionit midis Eagle Mobile sh.a dhe Vodafone Albania sh.a”, Eagle Mobile sh.a, informon se kërkesa për ndërprerjen e këtij proçedimi vjen si rezultat i lidhjes së marreveshjes së interkoneksionit mes palëve në datë 13.12.2010 me kohëzgjatje 01.04.2010 deri më 31.03.2011;

## P Ë R K Ë T O A R S Y E:

1. Bazuar në pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 te nenit 115, te ligjit nr. 9918, nenin 99 e vijues te K.Pr.A (*mbi përfundimin e procedimit administrativ*), si dhe pikën 17 të nenit 21 të Rregullores së Brëndshme,

## V E N D O S:

1. Të mbyllë procedimim administrativ të filluar me Vendimin nr. 1450, datë 12.11.2010, të KD të AKEP, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Eagle Mobile sh.a dhe Vodafone Albania sh.a;
2. Të njoftohen palët e interesuara “Eagle Mobile” sh.a dhe “Vodafone Albania” sh.a për mbylljen e procedimit administrativ;

3. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: [www.akep.al](http://www.akep.al)

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

**K R Y E T A R I**  
**Piro XHIXHO**

**A N Ë T A R Ë:**

- 1. Alketa MUKAVELATI**
- 2. Benon PALOKA**
- 3. Ibsen ELEZI**
- 4. Zamira NURÇE**